**AKT THEMELIMI**
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**
**"13 - V" SH.P.K.**

Ky akt themelimi, u përpilua më datë 06/ 04/ 2023, nga ortakët themelues.

**Rezart Kastrati,** i datëlindjes 18.04.1974, lindur në Shkodër dhe banues në Tiranë, shtetas shqiptar, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar nga dokumenti pasaportë me nr.personal H40418129V.

**Bujar Muça,** i datëlindjes 02.12.1972, lindur në Elbasan dhe banues në Tiranë, shtetas shqiptar, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar nga dokumenti pasaportë me nr.personal H21202129E.

**Robert Bano,** i datëlindjes 01.09.1972, lindur në Vendreshe dhe banues në Tiranë, shtetas shqiptar, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar nga dokumenti letërnjoftim ID me nr.personal H20901230W.

**Xhelil Bajrami**, i datëlindjes 21.08.1973, lindur në Maqedoni dhe banues në Tiranë, shtetas shqiptar, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar nga dokumenti letërnjoftim ID me nr.personal H30821037J.

**Maksim Marku,** i datëlindjes 13.01.1968, lindur në Fier i Ri dhe banues në Tiranë, shtetas shqiptar, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar nga dokumenti letërnjoftim ID me nr.personal G80113102F.

të cilët me nënshkrimin e këtij akti dhe në përputhje me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", të ndryshuar dhe legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë, themelojnë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e cila do të ushtrojë aktivitetin në

përputhje me legjislacionin shqiptar, Aktin e Themelimit dhe dispozitat e Statutit bashkëlidhur, si pjesë integruese dhe thelbësore e këtij Akti Themelimi.

**Neni 1**

**Emërtimi dhe Forma e Shoqërisë**

1. Shoqëria emërtohet **"13 - V" Sh.p.k** dhe themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, (këtu e më poshtë **"Shoqëria"**).
2. Shoqëria themelohet në bazë të legjislacionit shqiptar dhe do të ushtrojë aktivitetin në përputhje me legjislacionin shqiptar, Aktin e Themelimit dhe dispozitat e Statutit.
3. Shoqëria ka vulën dhe logon e saj zyrtare.

**Neni 2**

**Selia**

Selia e Shoqërisë është në adresën: Rruga "Dine Hoxha", Ish Uzina Dinamo e Re, Pallati Bermon Ndërtim. Shoqëria ka të drejtë që me vendim te Asamblesë së Ortakëve të hapë degë, zyra, filiale ose përfaqësi të shoqërisë në qytete të tjera të Shqipërisë.

**Neni 3**

**Objekti**

Objekti i veprimtarisë së **Shoqërisë** përfshin aktivitetet e mëposhtme:

1. Ndërtime civile dhe ekonomike, industriale, turistike dhe tregti import export.
2. Studimin, projektimin, konsulencën, sipërmarrjen zbatuese, investimin sipas rastit, për realizimin me fonde publike dhe / ose jopublike të veprave me karakter shfrytëzimi dhe /ose administrimi publik dhe /ose privat si: ndërtimin e ndërtesave publike dhe private, rrugëve, urave, tuneleve, mbikalimeve e nënkalimeve, autostradave, traseve hekurudhore, digave dhe veprave bonifikuese e ujore, ujësjellësave, linjave mbitokësore dhe nëntokësore për energjinë dhe telekomunikacionet, ndërtimin dhe rehabilitimin e veprave ujitëse, centralet, objektet turistike, objektet ushtarake, objektet e kultit, rrjetet inxhinierie, portet,

aeroportet, objektet industriale, të gjitha restaurimet në përgjithësi, rikonstruksione të veprave të artit, montimet e konstruksioneve metalike etj.

3. Hapja dhe menaxhimi i hoteleve "Strukture Akomoduese 4 ose 5 yje", i godinave dhe ambjenteve ne te cilat ushtrohet aktivitet hotelierie.
4. Shfrytëzim miniere. Shfrytëzim gëlqeror, mineralesh etj.
5. Tregtim materiale ndërtimi. Prodhim materiale ndërtimi. Import-eksport karburantesh dhe transport i tyre.
6. Transport i mallrave për të tretë me qira dhe për llogari të vet brenda dhe jashtë vendit
7. Shfrytëzim miniere. Shfrytëzim gëlqeror, mineralesh Tregtim materiale ndërtimi, inerte, rërë, mermer, etj.
8. Mirëmbajtje, operim, menaxhim rruge, tunele, ura, mbikalime.
9. Grumbullimi dhe transportimi i mbetjeve urbane, mbetjeve jo te rrezikshme etj.
10. Zhvillimi i Agroturizimit, ndertime, mirembajtje të porteve, aeroporteve, terminaleve, puunime detare, punime Civile, etj.
11. Perpunimi, instalimi, prodhimi i mallrave industriale, sherbime te punimeve per infrastrukturen ndertimore, energjitike, sherbime te agjentit, subagjentit ne shitje blerje pasurie te luajtshme dhe te paluajtshem dhe brokerit per mardhenie kontraktimi midis paleve dhe mardhenie financiare, leasing, qeradhenie, qeramarrje, konsulence, marketing, export-import, sherbime transporti per nevoja te veta dhe per te trete.
12. Import – eksport për mallra, pajisje, produkte, makineri të ndryshme etj, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
13. çdo aktivitet tjetër tregtar që lejohet nga legjislacioni shqiptar

**Neni 5**

**Kohëzgjatja e shoqërisë**

Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj për një kohëzgjatje të papërcaktuar.

**Neni 6**

**Kapitali themeltar dhe kuotat**

1. Kapitali themeltar i shoqërisë është 7,000,000 (shtatë milion) lekë.
2. Shoqëria gjatë aktivitetit të saj mund të rrisë apo të zvogëlojë kapitalin e saj themeltar në përputhje me procedurat e përcaktuara në Statutin e shoqërisë dhe në ligjin tregtar shqiptar.
3. Pjesëmarrja e themeluesve ne kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme :
   - Ortaku themelues **Rezart Kastrati** zotërues i një kuote me vlerë të përgjithshme 1,400,000 (një milion e katërqind mijë) lekë që përbën 20 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
   - Ortaku themelues **Bujar Muça** zotërues i një kuote me vlerë të përgjithshme 1,400,000 (një milion e katërqind mijë) lekë që përbën 20 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
   - Ortaku themelues **Xhelil Bajrami** zotërues i një kuote me vlerë të përgjithshme 1,400,000 (një milion e katërqind mijë) lekë që përbën 20 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
   - Ortaku themelues **Maksim Marku** zoterues i një kuote me vlere të përgjithshme 1,400,000 (një milion e katërqind mijë) lekë që përbën 20 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
   - Ortaku themelues **Robert Bano** zotërues i një kuote me vlerë të përgjithshme 1,400,000 (një milion e katërqind mijë) lekë që përbën 20 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

**Transferimi i Kuotave**

Kuotat e shoqërisë mund të transferohen plotësisht ose pjesërisht në përputhje me proçedurat e parashikuara në Statutin e Shoqërisë.

**Neni 8**

**Organizimi dhe funksionimi**

Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, do të bëhet në përputhje me rregullat e përcaktuara në Statutin e Shoqërisë, i cili i bashkangjitet këtij Akti Themelimi dhe përbën pjesë integrale të tij.

**Neni 9**

**Drejtimi i Shoqërisë**

## Neni 9

## Drejtimi i Shoqërisë

1. Drejtimi i shoqërisë "**13 - V**" S.H.P.K do tëkryhet nga administratori i saj **Z.Robert Bano**, i cili është njëkohësisht edhe ortak në shoqëri me 20 % të kuotave, i datëlindjes 01.09.1972, lindur në Vendreshe dhe banues në Tiranë, shtetas shqiptar, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar nga dokumenti letërnjoftim ID me nr.personal H20901230W.
2. Ai përfaqëson shoqërinë në të gjitha marrëdhëniet e saj me të tretët.
3. Kohëzgjatja e ushtrimit të detyrës është 5 (pesë) vjet.
4. Emërimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qëndrën Kombëtare të Biznesit.
5. Administratori ka tedrejtëtëcaktojëfinancierë, likuidatorëpërproblemet e shoqërisë, sidhetëpunësojë persona tetjere ne shoqeri. Financierinxjerrregullishttreguesitfinanciarë 3-mujore, 6-mujorëdhevjetoreteaktivitetitteshoqërisë.

## Tëtjera

## Neni 10

Shoqëria fiton zotësinë për të vepruar me regjistrimin e saj në Qëndrën Kombëtare të Biznesit.

## Neni 11

Gjykata kompetente për zgjidhjen e të gjitha mosmarrveshjeve midis ortakëve dhe interpretimin e akteve të shoqërisëështë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

## Neni 12

Ky Akt Themelimi hyn në fuqi dhe është i detyrueshëm për zbatim në momentin e firmosjes nga ortakët themelues.

## Neni 13

Ky Akt Themelimi është hartuar në 7 (shtatë) kopje në shqip.

**ASAMBLEJA E PËRGJITHSME E ORTAKËVE**

**TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**"13 - V" shpk**

**REZART KASTRATI**

**BUJAR MUÇA**

**ROBERT BANO**

**XHELIL BAJRAMI**

**MAKSIM MARKU**